



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR
REKTORATI

NJOFTIM PËR PJESËMARRJE NË KONKURSION

Gara e studentëve: Sfida Covid-19

<https://www.britishcouncil.al/programmes/education/sep/policy-challenge>

Këshilli Britanik ka hapur thirrjen për ide të politikave për të gjithë studentët e talentuar të cilët janë në studime dhe ata që kanë përfunduar studimet për të adresuar sfidat që ka sjellur pandemia COVID-19.

Krahas gjetjes së një mundësie për të shkuar në zgjidhjen e disa prej çështjeve më të rëndësishme që bota po përballë sot, kjo sfidë do të shërbejë si një mundësi për krijimin e një rrjeti me studentë të shkëlqyer nga i gjithë vendi dhe për të fituar një kurs online në një nga universitetet në Mbretërinë e Bashkuar.

Çfarë është Gara e studentëve Sfida Covid-19?

Gara e studentëve Sfida Covid-19 është një sfidë e studentëve dedikuar propozim-hartimit të politikave që synojnë të zgjidhin sfidat më problematike të sotme. Pjesëmarrësit e sfidës janë të ftuar të dorëzojnë përmbledhje të politikave në përgjigje të njëres prej sfidave më aktuale (shih më poshtë) deri më 8 Dhjetor 2020. Pesë individët/ekipet më të mira do të kalojnë në finalen online ku do të kenë 3 minuta për të paraqitur idetë e tyre në një panel të përbërë nga politikëbërës, udhëheqës të OJQ-ve dhe përfaqësuesit e donatorëve. Aktiviteti online do të mbahet në gjysmën e dytë të Janarit 2021.

Pse duhet të marrin pjesë studentët në këtë garë?

Përfitimet e pjesëmarrësve në konkurs përfshijnë, por nuk kufizohen si më poshtë:

- mundësi për të përfituar kurse online. Fituesit e vendit të parë do të marrin një kupon prej 1,500GBP për kurse në universitetet në Mbretërinë e Bashkuar, ndërsa fituesit e vendit të dytë do të marrin kupon prej 1.000 GBP
- propozimi juaj do të botohet në koleksionin online të Këshillit Britanik bashkë me përmbledhjet e politikave të të gjithë finalistëve
- krijimi i një rrjeti kontaktesh me studentë të tjerë me profile të ndryshme akademike
- zhvillimi i mendimit kritik, shkathtësive të zgjidhjes së problemeve si dhe komunikimit.

Cilat janë kërkesat e sfidave?

Kërkesat e sfidave përfshijnë tematika të fushave të ndryshme midis të cilave pjesëmarrësit do të duhet të zgjidhin problemin specifik në nivel lokal ose kombëtar, ose në universitete dhe spitale, dhe të provojnë ta zgjidhin atë me anë të propozim-politikave të tyre. Kërkesat për këtë sfidë janë si më poshtë:

Sfida # 1: Si t'i përgjigjemi dhe të rikuperohemi nga COVID-19 duke forcuar drejtësinë sociale dhe mbrojtjen e më të rrezikuarve?

Sfida # 2: Si të reagojmë dhe të rikuperohemi nga COVID-19 në një mënyrë që ndihmon ndërtimin e qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike?

Kush ka të drejtë të marrë pjesë në këtë garë?

Të gjithë studentët që aktualisht janë regjistruar në një program bachelor ose master në të gjitha Universitetet në Shqipëri (publike dhe private). Studentët duhet të jenë të moshës midis 18-30 vjeç nga afati origjinal i dorëzimit (08 Dhjetor 2020).

A është gara për individë apo skuadra?

Konkursi është i hapur për individë dhe ekipe deri në 3 anëtarë. Aplikimet individuale dhe ato ekipe do të trajtohen në mënyrë të barabartë, e gjithashtu edhe aplikacionet nga aplikantët nga një fushë e studimit si dhe fusha të ndryshme të studimit (të cilët ne i inkurajojmë).

Si të aplikoni?

Studioni me kujdes udhëzimet e hollësishme për aplikim, si dhe udhëzimet për të shkruar përmbledhje të politikave dhe na dërgoni aplikimin tuaj, së bashku me të dhënat bazike për anëtarët e ekipit tuaj, deri me 8 Dhjetor në adresën e emailit marinela.seitaj@britishcouncil.org

Cilat janë datat kryesore në këtë proces?

1. Aplikimi është deri me 8 Dhjetor 2020.
2. Ne do të përzgjedhim pesë përmbledhjet më frymëzuese deri me 10 Janar 2021.
3. Përgatitjet e finales së madhe do të bëhen në Janar 2021.
4. Finalistët do të paraqesin idetë e tyre në një prezantim prej 3 minutash para anëtarëve të jurisë në eventin online në Janar, 2021.
5. Ne do të publikojmë në internet koleksionin e të gjitha përmbledhjeve të politikave të finalistëve në Shkurt 2021.

Sfida e Politikave të Studentëve COVID-19 është pjesë e Programit të Angazhimit Shkencor në Ballkanin Perëndimor (SEP), financuar dhe zbatuar nga Këshilli Britanik.

Referohuni linkut për informacione të mëtejshme

<https://www.britishcouncil.al/programmes/education/sep/policy-challenge>